

VENDIM
Nr.1355, datë 10.10.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E OBJEKTEVE TË SEKTORIT MINERAR, QË DO TË
VLERËSOHEN PJESË TË SEKTORËVE PARËSORË NË ZHVILLIMIN EKONOMIK
TË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 3, e 5, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfshirjen në listën e aseteve, që do të jepen me koncesion, me çmimin simbolik 1 euro, të objekteve: “Miniera e kromit, Kalimash”, “Miniera e kromit, Vlahna”, “Fabrika e pasurimit të kromit, Kalimash” dhe “Fabrika e pasurimit të bakrit, Golaj”, të përcaktuara më hollësisht në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Objektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat vlerësohen se paraqesin interes për investime private, në fushën e veprimtarisë minerare, të jepen me koncesion, duke filluar me çmimin simbolik 1 euro.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është autoriteti kontraktues për dhënien me koncesion të këtyre objekteve.

4. Shpenzimet për realizimin e procedurave për dhënien me koncesion të përballohen nga ofertuesi fitues.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA 1

**ZONA E KONCESIONIT PËR MASIVIN VERILINDOR TË KROMIT PËRFSHIN
MINIERËN E KALIMASHIT, FABRIKËN E PASURIMIT TË KROMIT, KALIMASH DHE
MINIERËN E VLLAHNËS**

MINIERA E KROMIT KALIMASH, FABRIKA E PASURIMIT KALIMASH

Sipërfaqja totale e fushës minerare të trupave xeheror që përfshin miniera e Kalimashit (Kalimash 1 – Përroi i Batrës + Kalimash 2 + Kalimash 3, ku përfshihet dhe fabrika e pasurimit të kromit Kalimash) është 7.05 km² dhe përcaktohet sipas kontureve koordinative të tabelës 1.

**Tabela 1. Koordinatat e kontureve të zonës (në të cilën përfshihen të gjithë trupat
minerare dhe fabrika e pasurimit të kromit Kalimash)**

Pika e konturit	Koordinata Y	Koordinata X
1	44 38 500	46 57 000
2	44 38 500	46 58 000
3	44 40 000	46 59 000
4	44 43 000	46 59 000
5	44 43 000	46 56 700

6	44 42 000	46 56 700
7	44 42 000	46 58 000
8	44 41 000	46 58 000
9	44 40 000	46 57 000

Shënim. Zona minerare e koncesionit është e gjitha brenda lejes minerare të zbulimit (mineral kromi) nr.1125 të subjektit “Jab resources” sh.p.k., në kushtet specifike të së cilës janë përjashtuar objektet ekzistuese të kromit, pra zona e koncesionit.

MINIERA E KROMIT VLLAHNË

Sipërfaqja totale e fushës minerare të trupave xeheror për zonën e Vllahnës është 1.92 km², brenda kësaj zone është një leje minerare (leja minerare nr.769 me një sipërfaqe prej 0.1 km²) si rezultat sipërfaqja e lirë për koncesion është 1.82 km² dhe përcaktohet sipas kontureve koordinative të tabelës 2 dhe 3.

Tabela 2. Koordinatat e kontureve të zonës Vllahnë (në të cilën përfshihen të gjithë trupat minerare dhe koordinatat e lejes minerare nr.769)

Pika e konturit	Koordinata Y	Koordinata X
1	44 55 600	46 77 800
2	44 55 600	46 78 200
3	44 56 400	46 78 200
4	44 56 400	46 78 600
5	44 57 200	46 78 600
6	44 57 200	46 76 600
7	44 56 400	46 76 600
8	44 56 400	46 77 800

Shënim. Zona minerare e koncesionit është e gjitha brenda lejes minerare të zbulimit (mineral FeNi) nr.1133 të subjektit ADI sh.a., në kushtet specifike të së cilës janë përjashtuar objektet ekzistuese të kromit, pra zona e koncesionit.

Tabela 3. Koordinatat e konturit të lejes minerare nr.769 (Subjekti “Neza-2004”sh.p.k., leje shfrytëzimi kromi)

X = 4456810.0000	Y = 4677270.0000	Z = 0.0000
X = 4456940.0000	Y = 4677240.0000	Z = 0.0000
X = 4457040.0000	Y = 4677280.0000	Z = 0.0000
X = 4457040.0000	Y = 4677320.0000	Z = 0.0000
X = 4456935.0000	Y = 4677320.0000	Z = 0.0000
X = 4456830.0000	Y = 4677320.0000	Z = 0.0000
X = 4456835.0000	Y = 4677425.0000	Z = 0.0000
X = 4456840.0000	Y = 4677530.0000	Z = 0.0000
X = 4456940.0000	Y = 4677510.0000	Z = 0.0000
X = 4456950.0000	Y = 4677350.0000	Z = 0.0000
X = 4457120.0000	Y = 4677360.0000	Z = 0.0000
X = 4457140.0000	Y = 4677220.0000	Z = 0.0000
X = 4457160.0000	Y = 4677080.0000	Z = 0.0000
X = 4457130.0000	Y = 4677060.0000	Z = 0.0000

X = 4457090.0000	Y = 4677030.0000	Z = 0.0000
X = 4457050.0000	Y = 4677040.0000	Z = 0.0000
X = 4456940.0000	Y = 4677140.0000	Z = 0.0000
X = 4456830.0000	Y = 4677240.0000	Z = 0.0000
X = 4456670.0000	Y = 4677270.0000	Z = 0.0000
X = 4456680.0000	Y = 4677300.0000	Z = 0.0000

FABRIKA E PASURIMIT TË BAKRIT GOLAJ

Sipërfaqja totale e fabrikës së pasurimit të bakrit Golaj është 0.0615 km² dhe përcaktohet sipas kontureve koordinative të tabelës 4.

Tabela 4. Koordinatat e kontureve të fabrikës së pasurimit të bakrit Golaj

Pika e konturit	Koordinata Y	Koordinata X
1	44 49 627	46 78 163
2	44 49 701	46 78 229
3	44 50 007	46 78 276
4	44 50 002	46 78 149
5	44 49 962	46 78 026
6	44 49 640	46 78 122